

AKT THEMELIMI
"RETINA INSTITUTE"

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

Sot më datë 02.10.2024 e nënshkruara:

Zj. Jonida Veliaj, shtetase shqiptare, lindur në fshatin Tërpan Berat më 04.09.1985
dhe banuese në adresën: Rruga "Isa Boletini" nd.57 H.1" Lagja Çlirim Njësia
Bashkiake nr.1 5001 Berat, me kombësi Shqiptare, mbajtëse e dokumentit të
identifikimit nr. 036304892 dhe nr. personal I55904055H. Me vullnet të lirë dhe në
përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë
Tregtare" (Ligi i Shoqërive), ka vendosur të nënshkruajë këtë Akt Themelimi për
krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria) me
termat e mëposhtëm:

Neni 1 – Emri dhe forma ligjore


Emri i shoqërisë do të jetë "RETINA INSTITUTE" ndjekur në mënyrë të pandashme
nga shkurtimi "sh.p.k." i cili përfaqëson formën ligjore të saj.

Neni 2 - Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Antipatera" lagja 30 Vjetori
katër i parë zona kadastrale 8502 me numër pasurie 24/131-N1. Shoqëria sipas
parashikimeve të këtij akti dhe legjisacionit në fuqi mund të hapë si në Shqipëri dhe
jashtë saj qendra përfaqësi filiale degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat duke filluar prej datës së
regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të
Regjistrimit Tiranë. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim
të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



Neni 4 - Objekti i veprimtarisë

1. Kryerja e vizitave mjekësore për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të syrit, përfshirë matjen e shikimit, përshkrimin e syzeve ose lenteve të kontaktit, dhe monitorimin e shëndetit të syve.
2. Realizimi i ndërhyrjeve kirurgjikale për trajtimin e patologjive të syrit, duke përfshirë kirurgjinë refraktive (për korrigimin e defekteve të shikimit) dhe trajtimin kirurgjikal të kataraktit, glaukomës dhe sëmundjeve të tjera okulare.
3. Tregimi dhe shpërndarja e syzeve optike, lenteve të kontaktit dhe aksesorëve të ndryshëm për përmirësimin e shikimit.
4. Importimi, eksportimi dhe shpërndarja e pajisjeve të shikimit, përfshirë lente optike, lente kontakti, syze dielli dhe pajisje të tjera okulare të teknologjisë së avancuar.
5. Konsultimi dhe asistenca për pacientët në zgjedhjen e produkteve optike të përshtatshme për nevojat e tyre individuale, duke ofruar shërbime të personalizuara për përmirësimin e shikimit.
6. Kryerja e testeve dhe ekzaminimeve për diagnostikimin e sëmundjeve të syrit, përfshirë ekzaminimin me pajisje moderne teknologjike si tomografia e koherencës optike (OCT), retinografia dhe vizualizimi me anë të mikroskopisë.
7. Hapja dhe menaxhimi i qendrave të trajtimit të avancuar për sëmundjet e syrit, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të personalizuara për pacientët me sëmundje të ndërlikuara të shikimit.
8. Blerja, shitja dhe administrimi i pajisjeve dhe teknologjive të avancuara për kirurgjinë refraktive, lazerin për korrigimin e defekteve të shikimit dhe pajisje të tjera të përdorura në trajtimin e syrit.
9. Shitja e produkteve optike dhe lenteve të kontaktit në tregun ndërkombëtar, përfshirë përfshirjen në tregtinë e pajisjeve dhe teknologjive të reja për trajtimin e syve.
10. Kryerja e aktiviteteve mësimore dhe trajnimeve për specialistët dhe teknikët e optikës, duke përfshirë seminare dhe kurse të avancuara për teknologjitë më të fundit në kujdesin për shikimin.



Neni 5 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 (njëmillion) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 1.000.000 (njëmillion) lekë dhe zotërohet 100% nga Ortaku i Vetëm Zj. Jonida Veliaj. Kuota e kapitalit është e nënshkruar dhe e paguar.

Neni 6 - Administrimi

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë: - Asambleja e Ortakëve - Administratori (që mund të jetë ortak i shoqërisë ose edhe persona të tjerë jo ortak)
Administratori i Shoqërise do të jetë:

Të dhënat e identifikimit	Specimeni i nënshkrimit
<p>Zj. Jonida Veliaj, e bija e Kujtimit dhe e Shefikos, lindur me 04.09.1985, në Tërpan Berat dhe banues në Rrugën "Isa Boletini", nd.57, H.1", Lagja Çlirim, Njësia Bashkiake nr.1, 5001 Berat, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 036304892 dhe numër personal I55904055H, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar</p>	

Neni 7 - Të tjera

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjisacionit shqiptar. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë do të zgjidhen sipas ligjit shqiptar.



Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë, sot më datë
02/10/2024 në katër kopje në gjuhen shqipe

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "RETINA INSTITUTE" SH.P.K.

Jonida VELIAJ

Jonida Veliaj

RTA